

Për herë të parë, financimi buxhetor për Diasporën pjesë e Programit Buxhetor



Financimi buxhetor për diasporën do të jetë për herë të parë pjesë e programit buxhetor, sipas vendimit të qeverisë "Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023", të rishikuar. Ky vendim parashikon shpenzimet buxhetore për politikën shtetërore për Diasporën shqiptare, të cilat janë të mbështetura në vlerësimet e dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe Planin e Veprimit. Financimi buxhetor është përmbledhje e vlerësimit të buxheteve të institucioneve shtetërore përgjegjëse për diasporën shqiptare: Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës, Qendra e Botimeve të Diasporës, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Qeveria shqiptare do të ndërmarrë veprime të koordinuara ndërinstancionale për të mobilizuar burime financiare në komunikimin me donatorët e interesuar dhe për zhvillimin e projekteve të përbashkëta në zbatim të përparësive të dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës.



Vota e Diaspores Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore.

diaspora.gov.al/votim-dhe-rrgjistrim

Tekstet mësimore për Diasporën, diskutohet paketa e dokumenteve



Paketa e dokumenteve dhe procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për Diasporën ishin pjesë e diskutimit të Komisionit të përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën. Takimi u mbajt në Tiranë prej dy ditësh dhe komisioni u ndal në disa çështje të rëndësishme si pjesëmarrësit në konkurim, afatet e konkurimit, dokumentacionin e nevojshëm për konkurim, hapat që do të ndiqen për pranimin e teksteve në konkurim, mënyrën e vlerësimit të teksteve, çmimin e teksteve, shpalljen e listës paraprake të fituesve, fazën e ankimimit të vendimit, shpalljen e listës përfundimtare të teksteve mësimore për Diasporën, detyrimet e distributorëve/ shtëpive botuese, shpërndarja e teksteve etj. Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve.



Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës

është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale e ndryshme në Diasporë

rrjetiprofesionisteve.al

Arritjet dhe planet, ja çfarë vendosi Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën



Në mbledhjen e fundit për këtë vit, e cila u mbajt online, Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën shqyrtoi raportin vjetor të punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe prezantoi planin e punës për vitin e ardhshëm. Sigurimi dhe shpërndarja e 17.079 teksteve mësimore dhe literaturë plotësuese në 20 vende të botës, brenda muajit shtator ishte një arritje e suksesshme për QBD-në, si dhe realizimi i botimeve dygjuhëshe që nga fjalori dygjuhësh për fëmijë i realizuar në nëntë gjuhë, tek publikimet e serisë "Klasikët dygjuhësh", përgatitjen për botim dygjuhësh të dhjetë tregimeve të përzgjedhura nga vëllimi "Tregime të Moçme Shqiptar" të Mitrush Kutelit, përgatitjen dhe botimin e revistës së parë letrare "Letra nga Diaspora, si dhe botime informuese për nxënës dhe mësues në Diasporë.



Digjitalizimi

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

adld.al

QSPA pjesë e dokumentarit mbi arbëreshët




Një dokumentar për arbëreshët ka nisur xhirimet në mjediset e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Dokumentari do të trajtojë disa nga aspektet kryesore të kulturës dhe të traditave arbëreshe, si dhe synon të paraqesë një vështrim tërësor të raporteve shqiptaro-arbëreshe. Dokumentari, i cili pritet të realizohet së shpejti, do të transmetohet në kinematë shqiptare dhe italiane, si dhe në Televizionin Publik Shqiptar. Ai është një projekt i QSPA, me mbështetjen e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK) me skenar dhe regji nga Fabian Kati, drejtor fotografie Ilda Papajani dhe shtëpia e produksionit "Tunel". Thelbi i filmit është një udhëtim me shtatë ndalesa që përkojnë me qendra të identitetit arbëresh nëpër rajone të ndryshme të Italisë së jugut: Villa Badessa, Ururi, Chieuti, Greci, Melfi dhe Rionero në Vulture, Civita, dhe më në fund Contessa Entellina dhe Piana degli Albanesi në Sicili. Këto zhvillime të veçanta dhe të shumfishta të komunitetit arbëresh na ndihmojnë të kuptojmë më mirë edhe shoqërinë që nuk u largua nga Shqipëria.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

Krijimtaria e poetit arbëresh Lluka Perone në 100-vjetorin e lindjes



Në 100-vjetorin e lindjes së poetit arbëresh Lluka Perone krijimtaria e tij ishte temë e takimit të realizuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), në bashkëpunim me departamentin e letërsisë të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Ai që një nga intelektualët arbëreshë më aktivë për mbrojtjen dhe zhvillimin e traditave kulturore arbëreshe. Në fjalën e saj Drejtoresha e QSPA, Diana Kastrati foli për aktivitetet e shumta të ndërmarra nga QSPA për të kujtuar poet dhe kontribues të letërsisë arbëreshe. Prof. dr. Ymer Çiraku në fjalën e tij u fokusua tek poezia e Lluka Perone ndërsa Profesor Dr. Sadik Bejko u ndal tek roli i Lluka Perone si poet dhe pasuria që ai la pas në letërsinë tonë.

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



QBD/ Botohet shqip-italisht "Libri i xhunglës" dhe "Tre derrkucët"



Botimi i radhës i kolanës klasikët dy gjuhësh nga Qendra e Botimeve për Diasporën sjell dy nga përrallat më të dashura për fëmijët në shqip dhe italisht "Libri i xhunglës" dhe "Tre derrkucët".

Libri i sjellë në shqip nga Griselda Doka është i pajisur me ilustrime shumë të këndshme, ka një tekst të thjeshtë dhe me fjalët më të përdorshme që lehtësojnë mësimin e gjuhës në mënyrë argëtuese

Libri dygjuhësh shqip dhe italisht "Libri i xhunglës" dhe "Tre derrkucët", vjen falas për fëmijët shqiptarë të Diasporës dhe falas në versionin online për të gjithë.